

**Nr. Prot.**

*Tiranë, më 23.11.2021*

**Drejtuar:** Kryetarit të Këshillit të Ministrave,

**Z.Edi Rama**

**Për dijeni:** Ministrit të Financave dhe Ekonomisë,

**Znj.Delina Ibrahimaj**

Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

**Znj.Frida Krifca**

Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

**Znj.Ogerta Manastirliu**

Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve,

**Znj.Milva Ekonomi**

Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Komisionerit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Lënda:** Kërkesë për krijimin e një Task Force, me qëllim ndalimin e shitjeve online të produkteve ushqimore dhe joushqimore, që përbëjnë rrezik për konsumatorin, mashtrim të tij dhe që në shumë raste, tregtimi i tyre është i paligjshëm, si dhe mbylljen e faqeve web apo rrjete sociale për "subjektet" që nuk mund të kontrollohen fizikisht nga inspektoriatet përgjegjëse respektive.  
Krijimin e bazës ligjore, plotësuar dhe më akte nënligjore për shitjet "online".

I nderuar Z.Kryeministër!

Qendra ALERT është Organizatë Jofitimprurëse, e themeluar me Vendim të Gjykatës së Tiranës dhe ka në fokus kryesor të punës së saj mbrojtjen e konsumatorit. Qendra ALERT vepron dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 8788/2001 (i ndryshuar), me seli ne Tiranë, në adresën Rr.Fatmir Haxhiu, P.2, Shk 7.

Qendra ALERT e ka ndjekur me shqetësim prej disa kohësh mënyrën e tregtimit online, nëpërmjet internetit apo reklamave televizive, të qindra llojeve të produkteve të ndryshme, nga "persona" që e konsiderojnë vetën subjekte tregtare, por që në të vërtet nuk kanë asnjë një seli, asnjë magazinë, dyqan, as adresë postare dhe në shumë raste nuk janë të regjistruar as në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ndërsa gama e produkteve që ata tregtojnë është nga më të ndryshmet, si nga produktet ushqimore, suplemente ushqimore apo vitamina që nuk konsiderohen medikamente mjekësore, produkte farmaceutike, kremra e produkte të tjera shërues ose kozmetikë, pajisje elektroshtëpiake, elektronike, pajisje të tjera për banesa, enë kuzhine, veshëmbathje, pajisje dhe aksesore elektrike e madje deri te produktet e ndaluara të tregtohen, siç janë elektroskokët që mund të blihen e përdoren lehtësisht nga persona keqberës, fenelinat (bliz) që përdor policia ose ambulancat... Një mori e pafundme produktesh.

Ky fenomen ishte prezent dhe më parë, por hovin më të madhe e mori që nga fillimi i pandemisë "Covid-19". Së pari, për faktin se, konsumatorëve iu ofrua një mundësi blerjeje e lehtë, ndërkohë që u shtuan në reklamimet online nga këto "subjekte" të medikamenteve, suplementeve "mrekullibërëse" kundër CovonaVirus.

I nderuar Z.Kryeministër!

Në situatën ku ndodhemi sot me shitjet online, mendojmë dhe besojmë se fusha e mundësisë për abuzime, duke mashtruar konsumatorët shqiptarë, duke rrezikuar seriozisht cilësinë e tyre të jetës, sigurinë e tyre të shëndetit dhe jetës, është më e madhe se kurrë më parë. Kjo, edhe falë teknologjisë dhe internetit, por edhe falë disa faktorëve të tjerë.

Së pari, shumë produkte joushqimore, pajisje elektroshtëpiake, veshëmbathje, enë kuzhine, aksesore etj, që janë dhe duhet të jenë objekt kontrolli i Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregjeve, vëreksi e MFE, nuk është e mundur të kontrollohen për konformitetin e tyre, sepse është Dogana e para ajo që duhet të verifikojë konformitetin me rregulloret dhe ligjet e BE, por edhe se tregohen vetëm "online" nga të ashtuquajturat subjekte që nuk kanë NIPT, nuk kanë adresë postare dhe as magazina apo dyqane fizike.

Së dyti, produkte të ndryshme si vitamina apo suplemente ushqimore, futen në territorin e Republikës së Shqipërisë (përrjashtuar dhe shumë raste kontrabandë) dhe nuk analizohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, por shikohet vetëm nga dokumentacioni dhe shkojnë kushedi se ku e në sa "shitës online" pa asnjë identitet tregtar.

Së treti, pajisje të rrezikshme dhe të ndaluara për blerje pa autorizime të veçanta, gjenden lehtësisht në faqet e internetit apo nëq rrjetet sociale. Konkretisht, feneliza policie mund të blejë kushdo sot onlinë e gjithashtu edhe paralizues elektroskok me bateri, që shkarkojnë deri në 10000 volt e që janë mjet lehtësisht i përdorshëm për të kryer vepra penale.

Në shumë raste, konsumatorët nuk kanë ku të ankohen apo të zgjidhin problemin e tyre, sepse "subjekti" shitës funksionon vetëm nëpërmjet rrjeteve sociale dhe në shumë raste, as nuk

përgjigjen në numrat e telefonit të vendosur aty, e aq më pak të zgjidhin problemet e hasura me produktet e shitura.

Faqet online, web apo rrjete sociale janë të jembushura me produkte joushqimore edhe ushqimore, saqë të vjen të qeshësh e të qash kur shikon emrat e tyre... që nga "mjalti dobësues", "mjalt për femra që duan të mbeten shtatzënë", produkte që të mbrojnë nga Covid19, apo të tjera që, nëse do të ishin aq efikase, shumë mjekë di të "dorëzonin diplomat", pasi nuk do të ishin më të dobishëm. Për të mos folur për "dyshekët me aloe vera", produktet kozmetike dhe të gjitha ato që ne përdorim në jetën e përditshme.

E gjitha kjo shndërrohet në rrezik potencial për shëndetin dhe jetën e konsumatorëve, të cilët nuk dinë asgjë për pasojat, apo nëse iu ndodhin, nuk kanë asnjë informacion se nga iu erdhi. Konsumatorët, fatkeqësisht gënjehen edhe nga të njëjtat reklama, ku në shumë produkte thuhet se, "është prodhuar në Europë", apo edhe personazhet publike që bëhen imazhi i tyre.

Perceptimi për origjinën është për në BE, por në Europën kontinentale ka dhe shtete të "botës së tretë". Gjithësesi, edhe nëse do të thuhej në BE, ky informacion është tërësisht i paverifikueshëm, pasi mungesa e dyqaneve fizike të këtyre kompanive dhe funksionimi vetëm online, e bën konsumatorin shqiptar më të pambrojtur.

Qendra ALERT gjykon dhe mendon se, moria e produkteve që reklamohen e tregtohen vetëm online, janë një burim rreziku për mashtrimin, rrezikun e shëndetit dhe të jetës të konsumatorëve shqiptarë. Është një tregti në shumicën e rasteve ilegale, jashtë kontrollit të të gjitha strukturave inspektuese, duke u shndërruar në një risk potencial. Veç kësaj, duke shitur të paregjistruar në organet tatimore, i shkaktojnë shtetit dhe shuma të mëdha humbje financiare nga mospagesa e detyrimeve financiare.

Në kohët ku jetojmë, gjykojmë që konsumatorët janë të pambrojtur dhe të rrezikuar përballë këtij tregu fatkeqësisht jashtë çdo kontrolli.

Për këto arsye, në muajin qershor 2021, Komisioni Evropian propozoi reformimin e ligjit të BE-së për sigurinë e produkteve. E quajtur "Direktiva e Përgjithshme e Sigurisë së Produkteve", Komisioni synon ta kthejë atë në një Rregullore. Ky është një hap i rëndësishëm, pasi ligji daton në vitin 2001 dhe nuk pasqyron më një treg ku njerëzit blejnë "online" dhe shumë produkte nuk gjenden në asnjë vend tjetër. Ky ligj është gjithashtu thelbësor, pasi;

- a) ai përcakton se çfarë përbën një produkt "të sigurt",
- b) u jep autoriteteve kombëtare kompetenca shtesë të mbikëqyrjes së tregut dhe
- c) përcakton se kujt mund t'i drejtohen ato autoritete në zinxhirin e furnizimit, nëse diçka nuk shkon me një produkt.

Ligje apo rregullore të tilla do t'i shërbenin edhe Shqipërisë, pasi forcojnë mbikëqyrjen e tregut në vendin tonë, duke përmirësuar gjurmueshmërinë përgjatë zinxhirit të furnizimit.

Grupet e konsumatorëve, shpesh gjejnë produkte të rrezikshme të shitura në internet përmes tregjeve online. Dhe, tregjeve "online" nuk u jepet pothuajse asnjë rëndësi për kontroll në vendin tonë, për sigurinë e produkteve që u dërgohen konsumatorëve. Kanalet e shpërndarjes përmes të cilit blihet një produkt nuk mund të përcaktojnë mbrojtjen e konsumatorit.

Qendra ALERT i nxit vendimmarrësit që t'i konsiderojnë tregjet si 'importues', në mënyrë që autoritetet t'u adresojnë atyre çështjet për sigurinë e produkteve.

**Për këto arsye, Qendra ALERT kërkon nga Ju, ngritjen e menjëhershme të një Task-Force ndërinsitucionale, por edhe miratimin e një Akti Normativ me fuqinë e ligjit që:**

- ✚ Të hartohet dhe miratohet një Akt Normativ me fuqinë e ligjit, për rregullimin e tregut të shitjeve online
- ✚ Të hartohen e miratohen VKM, Urdhëra, Udhëzime, Rregullore, për funksionimin brenda standardeve ligjore dhe nën kontrollin e institucioneve respektive.
- ✚ Të krijohet një Task-Forcë ndërinsitucionale për ndërhyrje të menjëhershme në tregjet "online" dhe kontrollin e tyre.
- ✚ Të evidentohen shitjet online në rrjete apo web-e që nuk kanë dyqane fizike dhe nuk janë të regjistruar në QKB.
- ✚ Të mbylLEN faqet e tyre dhe të bllokohen produktet që mund të kenë diku e të ndalohet shitja.
- ✚ Të përcaktohen rregulla të qarta për reklamimin dhe tregtimin online, nga subjekte të ligjshme që duan ta ushtrojnë këtë veprimtari nëpërmjet internetit, si në të dhënat e sakta dhe të qarta të produkteve që shesin; të dhënat tenike, specifikimet, publikimin e deklaratave të konformitetit, certifikatat e origjinës për çdo produkt, raport-analizat nëse janë produkte apo suplemente ushqimore dhe çdo detaj të mundshëm, siç bëjnë faqet ndërkombëtare të shitjes online apo të kompanive serioze.
- ✚ Të ndalohen emërtimet dhe etiketimet mashtruese të produkteve, veçanërisht atyre ushqimore apo suplementeve të ndryshme që futen po në këtë kategori.
- ✚ Të merren masa urgjente për kontrolle në subjektet që reklamojnë e tregtojnë online, por që kanë dhe dyqane apo magazina dhe NIPT, me qëllim kontrollin e produkteve që tregtojnë, për ligjshmërinë, konformitetin dhe sigurinë e konsumatorit, të të gjitha natyrave e llojeve.
- ✚ Të ndermerren iniciativa ligjore për kontrolle rigorozë, të dokumenteve dhe t'ju bëhen analiza të herëpashershme në të gjitha vendkalimet kufitare, porte, aeroporte dhe rrugët tokësore, për të gjitha produktet që importohen nga subjektet që kanë prioritet tregtimin online.

**Duke shprehur besimin se Ju, si Kryeministër i Shqipërisë, si konsumator dhe si prind, se do të ndërmerrni një iniciativë të tillë, paraprakisht ju falenderojmë!**

Qendra ALERT

Granit SOKOLAJ

DREJTOR EKZEKUTIV